

**MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE**

Tiranë, 21 .11. 2013

Lënda: **Thirrje per shprehje interesi**

Drejtuar:
Projekti NO-BLE Ideas

Thirrje per shprehje interesi
Afati i fundit per aplikim 5 Dhjetor 2013/ Ora 16.00
Kuadri Ligjor

në zbatim të Ligjit Nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Evropian për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA) dhe marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Komisionit Evropian dhe Autoritetit Menaxhues me seli në Hungari për integrimin e fondeve nga Instrumenti për asistencën e para-antarësimit brenda programit të bashkëpunimit transkombëtar të Evropës Juglindore nga Fondi Evropian për zhvillim rajonal në kuadrin e objektivit të bashkëpunimit territorial evropian, (Menaxhim i Përbashkët), dhe në bazë të marrëveshjes së projektit NO-BLE Ideas, EE/D/0335/1.1/X, i bashkefinancuar nga Programi SouthEast Europe, Transnational Cooperation Programme, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, publikon thirrjen per shprehje interesi per pozicionet SI EKSPERTE TE JASHEM :

- 1. Koordinator projekti**
- 2. Oficer financiar**

Projekti NO-Ble Ideas, Young InNOvators Network for Sustainable Ideas in the Agro-Food Sector,
Projekti synon zhvillimin e qëndrueshëm me vetëdijen se inovacionet në sektorin agro -ushqimor mund të kontribuojnë në këtë zhvillim; bindja se inovacionet duhet të përfshijnë sa më shumë ide të kërkuesve të rinj në sajë të mbështetjes së sipërmarrësve me shpirt inovativ (duke shkrirë kështu ofertën me kërkesën për inovacion), prania, në të gjitha vendet partnere, të

Jointly for our common future

festivaleve të inovacionit apo ngjarje të cilat mund të shtohen dhe kryhen në mënyrë sistematike.

Bazuar në sa më sipër, projekti është zhvilluar për të adresuar disa nevojat specifike të vendeve partnere : nevoja për të rritur pjesën e burimeve njerëzore të punësuar në shkencë dhe teknologji , nevoja për një përfshirje më të lartë të sektorit privat në shpenzimet për kërkim dhe zhvillim (K&ZH), dhe nevojën për të adresuar në përgjithësi shpenzimet e ulëta për K & ZH në shkencat bujqësore .

Për të adresuar probleme të tilla dhe nevojave të identifikuar, janë identifikuar katër objektiva specifike:

1) krijimin e kushteve bazë për të rritur dialogun, shkëmbimin dhe lëvizshmërinë ndërmjet qendrave kërkimore publike /private dhe për të promovuar zhvillimin dhe aplikimin e ideve novatore të të rinjve.

2) krijimin e një sistemi zyrash të ndërlidhura dhe një platformë teknologjike për shkëmbimin dhe zhvillimin e ideve të novatorëve të rinj ;

3) rritjen e vizibilitetit të inovatorëve të rinj në mes të ndërmarrjeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e inovacionit nëpërmjet rritjes së karakterit transnacional të festivaleve ekzistuese të inovacionit ;

4) duke favorizuar shkrirjen midis kërkesës për inovacione (ndërmarrjet) dhe ofertës (inovatorët e rinj), në mënyrë që të fillojnë idetë e reja në industrinë agro - ushqimore .

1. Koordinator projekti, me kohë të plotë

Kohëzgjatja e shërbimit: deri në fund të muajit Shtator 2014

Pershkrimi i punës:

- Të sigurojë që i gjithë projekti të realizohet në mënyrë sa më efikase dhe brenda afateve kohore të paracaktuara;
- Të menaxhojë të gjithë punonjësit e përfshirë në projekt;
- Të marrë përsipër drejtimin e të gjithë projektit;
- Të sigurojë që procedurat dhe standartet kombetare dhe të BE të zbatohen plotësisht gjatë gjithë projektit;
- Të menaxhojë procesin e planifikimit të projektit;
- Të menaxhojë sa më mirë buxhetin e planifikuar për projektin;
- Të raportojë në afatet e paracaktuara mbi ecurinë e projektit të nivelet e larta drejtuese.

Kualifikimet

Jointly for our common future

- Diplome universitare ne fushat: Shkenca Sociale ose Ekonomike (vertetuar me diplome).
- Të kenë njohuri shumë të mira në anglishten e folur dhe të shkruar, dhe të zotërojnë gjuhën shqipe; Njohja e gjuhës italiane përbën avantazh
- Të kenë aftësi në komunikim, eksperiencia në marrëdhëniet me publikun përbën avantazh,
- Të kenë njohuri kompjuterike: MS Office, Power Point, Outlook;
- Të kenë njohuri mbi politikat rajonale evropiane;
- Njohuri të mira të kuadrit institucional të Bashkimit European

2. Oficer Finance, me kohë të plotë

Kohëzgjatja e shërbimit: deri në fund të muajit Shtator 2014

Përshkrimi i punës:

Të kryej te gjitha KONSULENCAT PER mbarëvajtjen e NO-BLE network dhe No-BLE platform në përputhje me aktivitetet e të gjitha paketave.

Procedurat financiare ne menyre që i gjithë projekti të realizohet në mënyrë sa më efikase dhe brenda afateve kohore të paracaktuara;

Të marrë përsipër përgjegjesitë për veprimet financiare gjatë të gjithë projektit;

Të sigurojë që procedurat dhe standartet kombetare dhe të BE të zbatohen plotësisht gjatë gjithë projektit;

Të verë në zbatim procesin e planifikimit financiar të projektit;

Të menaxhojë sa më mirë buxhetin e planifikuar për projektin;

Të ketë njohuri të mira mbi PRAG të Bashkimit Evropian;

Të raportojë ne afatet e percaktuara mbi ecurinë financiare projektit të nivelet e larta drejtuese dhe në sistemin M.I.S.

Kualifikimet

- Diplomë universitare në fushat: Financë- Kontabilitet, (vertetuar me diplomë).
- Të kenë përvojë të vërtetuar ne fushen e menaxhimit financiar.
- Të kenë njohuri shumë të mira në anglishten e folur dhe të shkruar, dhe të zotërojnë gjuhën shqipe .
- Njohuri të mira mbi PRAG përbëjnë avantazh
- Të kenë njohuri kompjuterike: MS Office, Power Point, Outlook; dhe sistemin financiar M.I.S
- Njohuri te mira te kuadrit institucional te Bashkimit European

Jointly for our common future

Kriteret e përjashtimit per kandidatet:

Kandidatët do të përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurat e perzgjedhjes nëse: a) Kane falimentuar , kane ceshtje gjyqesore te hapura, kane aktivite te pezulluara ose jane subjekt i ndonje procesi gjyqesor.

b)Jane denuar per ndonje veper penale ne lidhje me sjelljen profesionale.

c) Jane shpallur fajtor per sjellje te papershtatshme profesionale .

d) Nuk kane permbushur detyrimet e pagesave te sigurimeve shoqerore apo pagesat e taksave ne perputhje me legjislacionin kombetar .

e) Kane qene subjekt i nje procesi gjyqesor per mashtrim , korrupsion apo perfshirje ne organizata kriminale apo ne nje aktivite te tjeter ilegal qe ndikon ne interesin financiar te Bashkimit Europian .

f)Aktualisht eshte duke iu nënshtruar një ndëshkimi administrativ të përmendur në nenin 96 të Rregullores Financiare (buxheti) / Neni 99 i Rregullores Financiare).

Procedura e aplikimit

Kandidatet e interesuar të cilët përmbushin kualifikimet e kërkuara duhet të dorëzojnë aplikimin e tyre në perputhje me termat e referencës të përcaktuara në këtë njoftim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 5 Dhjetor 2013, ora 16.00 me postë apo dorazi si dhe në rrugë elektronike dhe duhet të përmbajnë :

- Kërkesë e shoqëruar me një letër motivimi
- Një CV në formatin European në gjuhën angleze
(link <http://europass.cedefop.europa.eu/europass>)
- Një kopje diplome , vërtetime të punës, apo dëshmi.

Personat e perzgjedhur do te njoftohen per intervisten qe do te kryhet brenda dates 6 dhjetor 2013.

Kontratat per personat e perzgjedhur lidhen me 6 Dhjetor .

Aplikimet dorëzohen me poste ose dorazi ne adresen :

Aplikim per Eksperte te jashtem /Projekti NO-Ble Ideas
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
Blvd."Deshmoret e Kombit",nr.2, kp.1001,Tirane

Dhe version elektronik i dokumenteve ne e-mail:

noblealbania@bujqesia.gov.al

auron.meneri@bujqesia.gov.al

Jointly for our common future

